



**OPERATORËT EKONOMIKË
TË AUTORIZUAR**
Plani Strategjik 2022-2025

Koncepti OEA bazohet tek partneriteti doganë-biznes dhe nënkupton që marrëdhëniet midis tyre duhet të ndërtohen gjithmonë në parimet e transparencës së ndërsjelltë, korrektësisë dhe paanshmërisë, me qëllim që operatorët ekonomikë, me vullnet të lirë, të plotësojnë një sërë standartesh për të garantuar arritjen e objektivave të përbashkëta të sigurisë në zinxhirin e furnizimit.



I. HYRJE

Operatori Ekonomik i Autorizuar (OEA) është një status i lëshuar për “bizneset me besueshmëri” të cilët mund të përfitojnë nga shumë thjeshtime doganore. Një operator ekonomik mund të aplikojë për statusin OEA nëse ushtron aktivitetin e tij në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe përmbush kriteret e vendosura në nenin 41 të Kodit Doganor.

Njohja reciproke e operatorëve ekonomikë të autorizuar nga autoritetet doganore të vendeve të rajonit (CEFTA) konsiderohet një mundësi e madhe për zhvillimin e biznesit në tregun rajonal dhe në të ardhmen edhe në atë europian. Në një treg ndërkombëtar të hapur, ky status është një prezantim dinjitoz i biznesit tek partnerët dhe i mundëson mbajtësit të këtij autorizimi përdorimin e logos së OEA në dokumenta tregtarë.

Legjislacioni doganor në lidhje me OEA është në përputhje të plotë me atë europian dhe rregullohet sipas:

- Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligjit nr. 18/2018, datë 05.04.2018, “Për ratifikimin e protokollit shtesë 5 të marrëveshjes për amendimin dhe aderimin në marrëveshjen e tregtisë së lirë të Europës Qendrore”;
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 651, datë 10.11.2017, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014, Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

Dispozitat e reja lehtësojnë procedurat doganore për operatorët ekonomikë, ulin kostot dhe rritin sigurinë ligjore për to, duke sjellë një sërë përmirësimesh në lehtësime e thjeshtime të rregullave dhe procedurave doganore, dhe synuar kështu përshtatjen dhe ecjen paralelisht me zhvillimet e tregtisë ndërkombëtare si dhe me nevojat e operatorëve ekonomikë.

Deri në Maj 2022, administrata doganore shqiptare ka lëshuar 8 certifikata OEA të cilat përfshijnë të dy tipet e këtij autorizimi:

- a) *Thjeshtime Doganore (OEA-D)*;
- b) *Sigurinë dhe Mbrojtjen (OEA-S)*.

8 operatorët ekonomikë të autorizuar operojnë sipas sektorëve të mëposhtëm:

- 4 operatorë ekonomikë - Importues/distributorë produktesh ushqimore dhe industriale
- 1 operator ekonomik - Sektori automotive
- 1 operator ekonomik - Manufakturë/Prodhues/Eksportues
- 1 operator ekonomik - Importues/Tregti me pakicë/Ndërtim
- 1 operator ekonomik - Eksportues i produkteve ushqimore

Me përmirësimin e vazhdueshëm të statusit OEA si dhe duke krijuar kushtet për realizimin e prioriteteve strategjike të përmendura në këtë dokument, do të shkohet në rritjen e mëtejshme të njohjes së rëndësisë së OEA (thjeshtimet në procedurat doganore që ai ofron) për mbajtësit e këtij statusi, administratën doganore si dhe aplikantët e mundshëm nga fusha e sipërmarrjes.

II. PRIORITETET STRATEGJIKE

Përmirësimi i konceptit të operatorëve ekonomikë të autorizuar dhe implementimi i plotë i lehtësirave që mbajtësit e këtij autorizimi përfitojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe vendeve anëtare të CEFTA-s do të realizohet si më poshtë:

1. Përmbyllja e procesit të marrëveshjeve për njohjet e përbashkëta për programin OEA;
2. Thjeshtimi dhe lehtësimi i mëtejshëm i procedurave doganore për mbajtësit e statusit OEA;
3. Ndërtimi i një partneriteti të qëndrueshëm ndërmjet autoriteteve doganore dhe operatorëve ekonomikë të autorizuar;
4. Implementimi i procedurave doganore më efçiente nga stafi i administratës doganore;
5. Ndërgjegjësimi i biznesit për benefitet e mbajtjes së statusit OEA dhe rritja e numrit të operatorëve ekonomikë të autorizuar që kanë role të ndryshme në zinxhirin e furnizimit kombëtar e ndërkombëtar.

III. AKTIVITETET

Përmbushja e qëllimeve dhe objektivave strategjike kërkon angazhimin dhe bashkërendimin e punëve ndërmjet shumë segmenteve të përfshirë në këtë proces.

1. *Harmonizimi i legjislacionit kombëtar në përputhje me kuadrin ligjor të BE-së në lidhje me OEA*

Legjislacioni kombëtar në lidhje me Operatorët Ekonomikë të Autorizuar është në përputhje të plotë me atë të Bashkimit Europian, megjithatë herë pas here mund të nevojitet përditësimi i tij me dispozita, rregullore apo akte të tjera ligjore.

2. *Përditësimi i marrëveshjeve të brendshme*

- Reduktimi i kontroleve dokumentare e fizike për mbajtësit e statusit OEA;
- Gjetja e mundësive të reja për rritjen e shkëmbimit të vazhdueshëm të informacionit ndërmjet sektorëve/drejtorive të strukturës organizative doganore dhe strukturave të tjera shtetërore;

- Hartimi i një procedure standarte për përdorim të brendshëm për deklarimin e mallrave e cila ju siguron prioritet në kontrolle mbajtësve të statusit OEA.

3. Bashkëpunimi ndërinstitucional

Hartimi i Memorandumeve të Bashkëpunimit (MoU) me agjenci apo struktura të tjera shtetërore që konsistojnë në rritjen e shkëmbimit të informacioneve të disponueshme sipas fushave të përgjegjesisë si dhe zgjerimi i procedurave të thjeshtuara apo lehtësimit i mëtejshëm i tyre për mbajtësit e statusit/certifikatës OEA.

4. Zhvillimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit

Përmirësimi i funksionalitetit të sistemit të teknologjisë së informacionit për operatorët ekonomikë të autorizuar si dhe rritja e shkëmbimit të informacionit në lidhje me OEA-të me vendet e rajonit (anëtare të CEFTA).

5. Transparenca

- Përditësimi i vazhdueshëm i website-it zyrtar të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (<https://dogana.gov.al>) me zhvillimet më të fundit në lidhje me OEA-të dhe me informacion të nevojshëm (udhërrëfyes, broshura, materiale informuese etj.) për operatorët ekonomikë që mund të jenë të interesuar për të aplikuar për statusin OEA.
- Publikimi i të gjithë aktiviteteve të zhvilluara në kuadër të përmirësimit dhe përditësimit të mëtejshëm të statusit OEA.

6. Organizimi i brendshëm

Rritja e numrit të punonjësve të angazhuar në të gjitha proceset e dhënies së statusit OEA (rritja e informimit dhe ndërgjegjësimit të biznesit, shqyrtimi i aplikimit, plotësimi i kriterëve dhe dokumentacionit përkatës, shkëmbimi i informacionit, kontrolli, monitorimi dhe rivlerësimi i statusit).

7. Zhvillimi i takimeve informuese dhe trajnimi i vazhdueshëm për rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore

- Organizimi i trajnimeve për punonjësit e administratës doganore (kryesisht ato të degëve doganore) me qëllim informimin e tyre për procedurat që duhen ndjekur dhe lehtësirat që ofron mbajtja e statusit OEA;
- Organizimi i vazhdueshëm i takimeve informuese për operatorë ekonomikë që potencialisht mund të aplikojnë për statusin OEA, dhomat e tregtisë që operojnë në vendin tonë si dhe me agjenci të tjera shtetërore që mund të përfshihen në këtë proces;
- Ftesa individuale drejtuar bizneseve që potencialisht i plotësojnë kriteret e kërkuara.

8. *Anëtarësimi i operatorëve ekonomikë të autorizuar dhe atyre potencialë në vendin tonë në shoqatën rajonale të OEA-ve*

Shoqata e OEA-ve do të mundësojë:

- Suport për OEA-të ekzistuese për rritjen e përfitimeve të mundshme;
- Mbështetje dhe inkurajim të OEA-ve të mundshme në procesin e aplikimit;
- Ndarje të eksperiencave më të mira mbi zbatimin dhe funksionimin e programit të OEA-ve;
- Dhënien e kontributit maksimal për mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit doganor të OEA-ve ;
- Identifikimin e fushave ku programi i OEA-ve mund të përmirësohet, nga perspektiva e biznesit dhe bazuar në përvojën e tij;
- Hartimin dhe zhvillimin e dokumenteve (qëndrime dhe politika) për të kontribuar për zhvillimin e politikave të OEA-ve si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë rajonal.

IV. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Realizimi dhe implementimi i pikave të përmendura në këtë dokument është i detajuar në planin që është pjesë integrale e kësaj strategjie dhe që përmban:

- aktivitetet e identifikuar;
- strukturat përgjegjëse/personat e angazhuar për realizimin e tyre;
- afatet kohore të nevojshme për implementim.

Grupi i punës i ngritur për shqyrtimin e aplikimeve, verifikimin e dokumentacionit dhe të përmbushjes së kriterëve, kontrollin, lëshimin e certifikatës OEA si dhe monitorimin e saj, informon Drejtorin e Përgjithshëm në lidhje me realizimin e planit të parashikuar.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Genti Gazheli

